VENDIM
Nr. 472, datë 30.7.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KALIMASH–MORINË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Kalimash–Morinë".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë "arë" dhe tokë "truall", me një vlerë të përgjithshme prej 2 474 632 (dy milionë e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 2 474 632 (dy milionë e katërqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e dy) lekësh të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2021.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësive në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Kukës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIN RRUGOR "KALIMASH–MORINË"

Nr.	PRONARI	TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT PASURISË						VLERA TOTALE (lek)	SHËNIME
						Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"				
	Emri Atësia Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pas.	Sip. totale (m^2)	Sip. (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)		
1	Fatmir Shuaip Dulla	1543	192/9	Truall	150				150	203	30,450.00	30,450.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Musa ShuaipDulla	1543	192/4	Truall	150				150	203	30,450.00	30,450.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Sadik Shuaip Dulla	1543	192/8	Truall	150				50	203	10,150.00	10,150.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	Han Shuaip Dulla	1543	192/3	Truall	150				150	203	30,450.00	30,450.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	Hajdin DanIstrefi	1543	192/2	Truall	300				300	203	60,900.00	60,900.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	Man Istref Istrefi	1543	192/6	Truall	150				24	203	4,872.00	4,872.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	Man Istref Istrefi	1543	192/10	Truall	150				29	203	5,887.00	5,887.00	Urdhër kufizimi
8	Tafil Kamber Oruçi	1543	191/2	Truall	430				231	203	46,893.00	46,893.00	Pasuria kufizohet me urdhër të regjistruesit nr. 218, datë 13.10.2020
9	Asllan NezirBraha	1543	193/2	Truall	260				57	203	11,571.00	11,571.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	Brah Sherif Braha	1543	193/3	Truall	230				64	203	12,992.00	12,992.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	Ajet Xhem Braha	1543	193/4	Truall	220				98	203	19,894.00	19,894.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
12	Brahim Selim Demhasa	1543	193/5	Truall	180				107	203	21,721.00	21,721.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
13	Destan Nezir Braha	1453	193/10	Truall	250				62	203	12,586.00	12,586.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
14	Beram Hysni Bardhoci	1453	193/11	Truall	220				72	203	14,616.00	14,616.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
15	Xhemali Ajet Brahaj	1543	193/12	Truall	210				166	203	33,698.00	33,698.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
16	Ali Dogjan Braha	1543	193/13	Truall	220				182	203	36,946.00	36,946.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
17	Petrit Rasim Oruçi	1543	211/2	Truall	480				252	203	51,156.00	51,156.00	Shtesa e sipërfaqes për arsyen e ndryshimit të projektit, urdhër kufizimi
18	Besim Veli Ademi	1114	22/132	Arë	1800	132	132	17,424.00				17,424.00	Kufizohet deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor
19	Ramis Hazir Ademi	1114	22/126	Arë	2030	325	132	42,900.00				42,900.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
20	Mahmut Veli Shahu	1114	28/25	Arë	1050	206	132	27,192.00				27,192.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
21	Meradije Mehmet Germizi	1115	228/63	Arë	1880	1626	132	214,632.00				214,632.00	Kufizim deri në konfirmimin e AMTP-së
22	Jahir Sinan Grosha	1115	83/5	Arë	1552	39	132	5,148.00				5,148.00	Urdhër kufizimi
23	Qemal Rakip Grosha	1115	83/6	Arë	1550	97	132	12,804.00				12,804.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
24	Qemal Rakip Grosha	1115	83/56	Arë	410	410	132	54,120.00				54,120.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
25	Ramadan Skënder Syla	2724	102	Arë	10500	2656	132	350,592.00				350,592.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
26	Vesel Vesel Laci	2724	99	Arë	10296	5570	132	735,240.00				735,240.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
27	Lije Selman Ymeri	2724	181/1	Arë	2225	1468	132	193,776.00				193,776.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
28	Ajdin Dogjan Syla	2724	101/5	Arë	2498	256	132	33,792.00				33,792.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
29	Isak Haziz Perzhita	2724	22/12	Arë	700	700	132	92,400.00				92,400.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
30	Sheme Fetah Syla	2724	125/3	Arë	3000	667	132	88,044.00				88,044.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
31	Bajram Nuhi Duraku	2724	180/24	Arë	7407.32	1298	132	171,336.00				171,336.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
	Shuma totale e shpronësimit											**2,474,632.00**	

Shënime:
1. Vlerësimi i tokës truall dhe i tokës arë është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".